



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi Nr. 40/17  
Data: 18.10.2017

Në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, neni 54 paragrafi 1.3 dhe 1.9 dhe neni 55, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar për Vlerësimin e Lejimit të Përqendrimit, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës *18 tetor 2017* mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **LEJOHET**, Përqendrimi i realizuar, ndërmjet përfitimit të kontrollit të pjesës së tyre takuese të aksioneve të CDI - KOSOVO që përbënë 100% të aksioneve në shitje dhe çdo të drejt që lidhet me aksionet në shitje pa barrë e me efekt nga mbyllja nga EMONA Sh.p.k.
- II. Nuk vërehen shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, nuk krijohet pozitë dominuese, sipas Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- III. **Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tremijë euro).
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Komisionit.

**A R S Y E T I M**

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim dhe plotësimin të lëndës (Nr. prot. 225/17-0/H) e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, (neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar Nr. Prot. 244/17-06/D të Njoftimit për realizimin e përqendrimit, Komisioni i AKK-së vlerëson se: